

VENDIM
Nr.235, datë 19.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.495, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, TË PERSONAVE DHE SASISË SË NEVOJSHME TË KARBURANTIT PËR PËRDORIM NGA ANIJET E PESHKIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat” , të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.495, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Shoqëri furnizuese e gazoilit, për anijet e peshkimit të jetë “Armo” sh.a., Fier. Çmimi i shitjes së gazoilit pa akcizë të jetë 40 lekë/litër.”.

b) Pas pikës 3, shtohen pikat 3/1 e 3/2, me këtë përmbajtje:

“3/1. Efekti financiar prej 181 900 000 (njëqind e tetëdhjetë e një milion e nëntëqind mijë) lekësh, për 6-mujorin e dytë të vitit 2006, për diferencën ndërmjet çmimit të programuar vjetor të “Armo” sh.a., dhe çmimit 40 lekë/litër, t’i paguhet kësaj shoqërie nga fondet e Buxhetit të Shtetit.

3/2 Furnizimi i anijeve të peshkimit të mbështetet në normativat bazë të harxhimit të karburantit, sipas anijeve dhe llojit të peshkimit, në përputhje me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.”.

c) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Në bazë të numrit të anijeve të peshkimit dhe të fuqisë së tyre motorike, sasia e gazoilit, për 1 vit, për nevojat e peshkimit sipas porteve, nuk duhet t’i kalojë sasi të mëposhtme:

- | | |
|---------------|---------------|
| i) Durrës | 7 200 tonë; |
| ii) Vlorë | 5 600 tonë; |
| iii) Shëngjin | 3 700 tonë; |
| iv) Sarandë | 1 500 tonë.”. |

ç) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të nxjerrin udhëzimin e përbashkët për procedurat dhe dokumentacionin e duhur për shpërndarjen e karburantit, nga prodhuesi “Armo” sh.a., te përdoruesi.”.

d) Pika 7 shfuqizohet.

2. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA 1

NORMATIVAT TEKNIKE DHE TEKNOLOGJIKE TË KONSUMIT TË KARBURANTIT PËR ANIJET E PESHKIMIT

I. Peshkimi fundor – Pellagjik (Koeficienti Lit/Kg = 0.84)

A- Anije peshkimi 150 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 150 = 24.7 \text{ kg/orë} = 29.3 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $29.3 \times 0.7 = 20.5 \text{ lit/orë}$

B- Anije peshkimi 300 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 300 = 49 \text{ kg/orë} = 58.2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $58.2 \times 0.7 = 40.8 \text{ lit/orë}$

C- Anije peshkimi 400 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 400 = 66 \text{ kg/orë} = 78.4 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $78.4 \times 0.7 = 54.9 \text{ lit/orë}$

D- Anije peshkimi 600 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 600 = 99 \text{ kg/orë} = 117.6 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $117.6 \times 0.7 = 82.3 \text{ lit/orë}$

E- Anije peshkimi 1000 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 1000 = 165 \text{ kg/orë} = 196 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $196 \times 0.7 = 137.2 \text{ lit/orë}$

II. Peshkimi me rrethim

A- Anije peshkimi 80 deri 600 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 300 = 49 \text{ kg/orë} = 58.2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $58.2 \times 0.50 = 29.1 \text{ lit/orë}$

III. Peshkimi selektiv

A- Anije peshkimi 80 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 80 = 14.4 \text{ kg/orë} = 17 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $17 \times 0.7 = 12 \text{ lit/orë}$

B- M/Fluga peshkimi 40 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 40 = 6.6 \text{ kg/orë} = 8 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $8 \times 0.7 = 5.6 \text{ lit/orë}$

C- M/Lanca peshkimi 20 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 20 = 3.4 \text{ kg/orë} = 4 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $4 \times 0.7 = 2.8 \text{ lit/orë}$

D- M/Lanca peshkimi 10 hp

- Konsumi orar max. = $165 \text{ gr/hp/orë} \times 10 = 1.7 \text{ kg/orë} = 2 \text{ lit/orë}$

- Konsumi orar/mes. i shfrytëzimit = $2 \times 0.7 = 1.4 \text{ lit/orë}$

Në përlllogaritjet e konsumit faktik të karburantit për anije dhe forma të ndryshme peshkimi janë marrë në konsideratë:

1. Gjysmë orë ndezje e motorit në bankinë para nisjes për të arritur parametrat teknikë të punës, si dhe praktikë nisje.

2. Në Durrës e Vlorë, dy orë ecje e lirë deri në zonën e peshkimit dhe dy orë kthim në port.
 3. Në Shëngjin dhe Sarandë, një orë ecje e lirë deri në zonën e peshkimit dhe një orë kthim në port.
 4. 20% e kohës në peshkim, llogaritet në lëshim veglash peshkimi dhe virim.
 5. 10% ecje e lirë, motori në minimum, grisje e karikim trate, kolaudim pajisje peshkimi etj.
 6. Rreth 60% e kohë pune efektive, tralim.
 7. Janë marrë në konsideratë edhe rastet e kthimit në port pa peshkim, për kohë të keqe, difekte teknike etj.
 8. Të gjitha përlllogaritjet, kanë si qëllim të përcaktojnë vetëm konsumin orar të karburantit, e për rrjedhojë sasia e karburantit që do të rimbursohet del nga koha e punës faktike në det të anijes, shumëzuar me konsumin e aprovuar në orë të paraqitur më sipër.
- Në përfundim përcaktimi i normativës së harxhimit të karburantit për anijet e peshkimit, është bërë në vija të përgjithshme mbi bazën e formulës:

$$K = 0.70 \times HP(\max.) \times \frac{S}{D} \times T$$

K--- Konsumi i karburantit të motorit për një kohë të caktuar

0.70 --- Koeficient mesatar i përdorimit të motorit

HP (max) -- Fuqi maksimale e motorit në HP (kuaj fuqi)

S --- Konsumi specifik i motorit sipas llojeve në gr/hp/orë

$$\frac{155-180}{2} = 165$$

D---- Densiteti i karburantit = 0.84

T----- Koha në punë e motorit, (e cila mund të zëvendësohet me distancën e përshkruar në milje, pjesëtuar me shpejtësinë në nyje të anijes)